

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, PRILL 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	3.4.2025	Kërkohet informacion nëse i është dërguar zyrtarisht, përfaqësuesve të Tik Tok, anketa e zhvilluar me prindrit për mundësinë e mbylljes së Tik Tok.	7.4.2025	Deleguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
2	4.4.2025	Kërkohet informacion nëse ka diskutime apo plane, shteti Shqiptar, që të ndërtojë central bërthamor.	7.4.2025	Informohet se ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, për t’ju përgjigjur pyetjeve, për të dhënë sqarime etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohet se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”, kërkesa duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet.	Përfunduar	Nuk ka
3	4.4.2025	Kërkohet informacion nëse i është dërguar zyrtarisht, përfaqësuesve të Tik Tok, anketa e zhvilluar me prindrit për mundësinë e mbylljes së Tik Tok.	7.4.2025	Informohet se ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, për t’ju përgjigjur pyetjeve, për të dhënë sqarime etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohet se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”, kërkesa duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet.	Përfunduar	Nuk ka
4	4.4.2025	Ne nje deklarate publike kryeministri Edi Rama deklaroi se jane ndertuar 450 shkolla. Ju lutem te na vini ne dispozicion listen e 450 shkollave te ndertuara te referuara nga Kryeministri, te ndara sipas qyteteve, vitit kur jane ndertuar apo rikonstruktuar dhe nese i perkasin arsimit baze apo te larte.	7.4.2025	Deleguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
5	9.4.2025	Kërkohet manërveshija dy palëshe, e ndryshuar, lidhur me mënyrën e përdorimit të qendrave të saj për azil-kërkuesit në Shqipëri, që përcakton se ato do të përdoren si Qendra Ndalimi për të huajt që u është mohuar kërkesa për azil dhe presin deportimin.	18.4.2025	Në përgjigje të kërkesës për informacion, dërgohet linku më poshtë, që përmban gjithë dokumentacionin shoqëruar të ligjit nr. 20, datë 22.2.2024 “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”. https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/83965523-1e30-48f5-8129-5161a23a2a3a	Përfunduar	Nuk ka
6	13.4.2025	Dërgohet propozimi për një projektligj që synon mbrojtjen e simboleve kombëtare dhe fetare.	14.4.2025	Deleguar Komitetit Shqiptar të Kulteve, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
7	16.4.2025	Kërkohet informacion lidhur me një çështje pronësie.	16.4.2025	Deleguar Zyrës së Bashkëqeverisjes, për kompetencë dhe trajtim.	Deleguar	Nuk ka
8	22.4.2025	Kërkohet informacion në lidhje me shpenzimet për dreka ose darka të organizuara nga Kryeministria, për raste specifike të pritjes apo përcjelljes së delegacioneve, për periudhën 2021-2025.	28.4.2025	Informohet se bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohet se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”, kërkesa për informacion duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet.	Përfunduar	Nuk ka
9	29.4.2025	Kërkohet informacion për numrin e projektligjeve të miratuara në Këshillin e Ministrave për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, për numrin total të dokumenteve strategjike dhe politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, për numrin e projektligjeve që do duhet të shoqëroreshin me vlerësimin e ndikimit (VNR/RIA) referuar përcaktimeve në Rregulloren e Këshillit të Ministrave për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, dhe për numrin e projektligjeve për të cilat është realizuar faktikisht vlerësimi i ndikimit rregullator dhe janë shoqëruar me VNR/ RIA për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024.	30.4.2025	Informohet se ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, për t’ju përgjigjur pyetjeve, për të dhënë sqarime etj. 1. Lidhur me kërkesën për numrin e projektligjeve të miratuara në Këshillin e Ministrave për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, mund të konsultohet linku: https://www.kryeministria.al/newsrooms/projekt-ligj/ 2. Lidhur me kërkesën për numrin total të projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për vitet 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, mund të konsultohet linku: https://www.kryeministria.al/newsrooms/vkn/ 3. Lidhur me kërkesën për numrin e projektligjeve që do duhet të shoqëroreshin me vlerësimin e ndikimit (VNR/RIA), të konsultohen përcaktimet në Rregulloren e Këshillit të Ministrave. 4. Lidhur me kërkesën për numrin e projektligjeve për të cilat është realizuar faktikisht vlerësimi i ndikimit rregullator dhe janë shoqëruar me VNR/ RIA, mund të konsultohet linku i Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, ku publikohen Raportet e Vlerësimit të Ndikimit, bazuar në Rregulloren: https://www.konsultimipublik.gov.al/	Përfunduar	Nuk ka